

Profili i Studios Ligjore Shkrela

Studio Ligjore Shkrela është themeluar ne Janar 2008. Falë aftësive të stafit tone profesionist ne mund te pergjigjemi sakte, efektivisht, shpejt duke perfshirë këtu si çështjet lokale, rajonale, kombëtare dhe nderkombetare. Objektivi dhe qellimi yne është të ndihmojmë klientët tane të arrijnë synimet e tyre ne fushen tregtare.

Që prej themelimit te Studios tone ne krenohemi për punën tone te shkelqyer dhe te palodhshme. Qëllimet tona për përparim dhe zhvillim janë të lidhura ngushtë me qëllimet e klienteve.

Ne i sigurojmë klientëve tanë eksperiencën e duhur dhe konsulencen në çdo disiplinë dhe fushe ligjore. Ne koordinojmë grupe të ndryshme interesi me qëllim negocimin, shqyrtimin e vendimeve dhe transaksioneve për mbrojtjen e interesave tuaja.

Aftesia e stafit të Studios tone në zotërimin e gjuhëve të huaja lehtëson komunikimin me klientët e huaj që investojnë në Shqipëri. Avokatët tanë kanë njohuri mbi te drejtat kombetare dhe nderkombëtare të biznesit dhe kanë eksperiencë të gjerë ne sistemet ligjore të rajonit.

Njohurite dhe respekti ynë për diferencat kulturore ndihmon në aftësitë tona për të menaxhuar sfidat e bërjes biznes në një komunitet global.

Ne ofrojmë për klientët tanë përgjegjshmëri, kujdes dhe fleksibilitet si dhe një komunikim me terma të kuptueshëm. Kjo përqsasje manifestohet në shumë mënyra duke filluar që nga garantimi i një përgjigje të shpejtë të telefonatave dhe emaileve të klientëve, duke ulur gjithashtu shpenzimet e parashikuara prej tyre.

Kualifikimet tona të ndryshme janë bashkuar në zotimin tonë për ti ofruar klientëve një shërbim ligjor sa me cilësor. Meqënëse kërkesat e klientëve tanë në fushën e tregtisë synojnë të zhvendosen drejt zhvillimeve në tregun nderkombëtar, kjo na detyron ne që të përshtasim konsulencën tonë drejt asaj që i shërben më mirë kërkesave të tyre.

Shërbimet e Studios Ligjore Shkrela nënkuptojnë angazhimin ndërmjet një eksperti tregu dhe grupit përkatës të punës. Për cdo suate ne punojmë ngushtësisht me klientët tanë për të kuptuar atë që ata presin dhe i sigurojmë që shërbimet që ne ofrojmë janë pikërisht në përputhje me kërkesat e tyre.

Studio jonë ofron një gamë të gjerë të shërbimeve ligjore me përsosmëri dhe profesionalizëm në fusha të tilla si: Ligji për Shoqëritë Tregtare, Kontratat, Antritust, Zgjidhja Alternative e Mosmarrëveshjeve, Banka dhe Financat, Sigurimet, e Drejta e Autorit, e Drejta Nderkombetare, Financimi i Projekteve Lokale, Ligji i Aviacionit, Pasuritë e Paluajtshme, Tatim - Taksat dhe Doganat, Punësimi, Procedurat Administrative, Çështjet Gjyqësore etj.

Në shërbimet që i ofrojmë klientëve tanë përqëndrohemi në këto fusha kryesore:

Shoqëritë Tregtare

Studio Ligjore Shkrela përfaqëson klientë të një spektri të gjerë të biznesit të sotëm global. Ne fokusohemi në objektivat e biznesit, përballemi me çështjet dhe punojmë me klientët tanë për të krijuar zgjidhje praktike për biznesin. Si nje grup i bashkuar pune ne e shohim biznesin dhe elementët ligjorë të funksioneve tona si nje te vetme. Ajo cka eshte me kuptim në fushën ligjore duhet te jetë me kuptim edhe në fushën e biznesit. Ne ofrojmë asistencë ligjore në çështjet e mëposhtme:

- Themelimi i Kompanive Tregtare, Degëve dhe Zyrave të Përfaqësimit;
- Regjistrimi i Kompanive në Qendren Kombetare te Regjistrimit;
- Regjistrimi i Kompanive në Autoritetet Shqiptare të Tatim - Taksave dhe Doganave;
- Procedurat dhe Konsulenca per marrjen e Licencave për biznesin;
- Ristrukturimi, Transformimi, Perthithja, Ndarja, Falimentimi dhe Likuidimi i Shoqërive Tregtare;
- Marrëveshjet Joint - Venture.

Kontratat

Duke u mbështetur ne eksperiencën tonë të gjerë ne u ofrojmë klientëve tanë konsulence te vazhdueshme ne hartimin e te gjithë llojeve te kontratave.

Bankat, Financat dhe Sigurimet

Studio Ligjore Shkrela ka nje eksperience te gjate përsa i përket ofrimit dhe garantimit të një game të gjerë shërbimesh për kompanitë investuese, investuesit privatë, kompanitë e sigurimit dhe ne fushen bankare. Disa prej shërbimeve që ofrojmë janë si më poshtë:

- Konsulence dhe Lehtësira në kreditim;
- Garancitë dhe instrumentat e sigurisë;
- Dokumentacioni për tregtimin e produkteve financiare;
- Aspektet rregulluese dhe operuese te aktivitetit te bankave, kompanive të sigurimit, fondeve të investimit, fondeve të pensionit dhe firmave të tjera financiare;
- Metodat e financimit për shoqëritë sipërmarrëse dhe shoqëritë investuese;
- Garancite;
- Zbatimi i Marrëveshjeve të Sigurimit;

Ndërtimi dhe Pasuritë e Paluajtshme

Studio jonë ndihmon që klientët të maksimizojnë përfitimet dhe të minimizojnë risqet për sa i përket blerjes, investimit, financimit dhe vënies në përdorim të pasurive të paluajtshme. Praktika jonë në fushën e ndërtimit përfshin përfaqësimin e të gjithë llojeve të klientëve (pronarë, investuesit, projektuesit, profesioniste, kontraktorët, nënkontraktorët, dhe furnizuesit). Ne jemi të përfshirë në çështjet e ndërtimit për një gamë të gjerë projektesh. Përsa i përket pasurive të paluajtshme dhe praktikave të ndërtimit ne vazhdimisht i ofrojmë klientëve tanë konsulencë në :

- Pasuritë e Paluajtshme;
- Blerja, shitja, dhe dhënia me qera e pasurive të paluajtshme;
- Përgatitja e dokumentave për të siguruar lejen e ndërtimit;
- Projektet investuese;
- Hartimi i kontratave të sipërmarrjeve, marrëveshjet me pronarët e pasurive të paluajtshme si dhe marrëveshje të tjera të nevojshme.

Taksat dhe Doganat

Studio Ligjore Shkrela ofron një eksperience të gjerë në fushën e Tatim – Taksave dhe Doganave. Ne bashkëpunojmë ngushtësisht me ekspertët kontabël dhe konsulentet ekonomike në mënyrë që t'i ofrojmë klientëve zgjidhjen më të mirë jo vetëm nga pikëpamja ligjore por edhe ekonomike.

Kodi i Punës

Në kohën kur ekonomia jonë po fokusohet gjithnjë e më shumë drejt shërbimeve dhe forcës punëtore është vendimtare për kompanitë të menaxhojnë burimet e tyre njerëzore në mënyrë sa më efektive dhe t'ju përgjigjen jo vetëm kërkesave për të drejtat kolektive por edhe kërkesave që kanë të bëjnë me të drejtat individuale të cilat po shtohen dhe po zëvendësojnë kërkesat kolektive. Studio ligjore Shkrela siguron konsulencë ligjore në çështjet e më poshtme:

- Hartimi i kontratave të punësimit si kolektive edhe individuale;
- Hartimi i rregullave të punës, manuale dhe rregulla të tjera të brendshme;
- Asistencë në procedurat individuale dhe masive të pushimit nga puna;
- Kujdesi i duhur në çështjet e punësimit;
- Ndryshimet në kodin e punës;

- Vlerësimi i marrëdhënieve midis punëdhënësve dhe punëmarrësve (përfshirë këtu agjencitë e punësimit);
- Cështje gjyqësore që lindin nga marrëdhëniet e punës;

E drejta e autorit dhe konkurenca e padrejtë

Në një botë ku pronësia intelektuale mund të jetë pasuria më me vlerë e një klienti Studio Ligjore Shkrela është e fokusuar në sigurimin e shërbimeve të shumëanshme të projektuara këto të fundit për t'i ndihmuar klientët të arrijnë avantazhe konkurruese maksimale të cilat mund të realizohen nga përdorimi i pasurive të tilla. Fushat ku veprojmë përfshijnë reklamimi në përputhje me rregullat, Konkurenca e Pandershme, E Drejta e Privatësisë dhe e Publikimit, Ruajtja e Sekretit Profesional dhe cështjet gjyqësore për Markat dhe Patentat.

Konkurenca dhe Antritrustet

Për shkak të vëmendjes së kushtuar nga BE përsa i përket rregullave mbi konkurrencën dhe antitrusteve, një biznes sado i madh apo i vogël të jetë nuk mund të përballojë gjërat që arrijnë deri në 10 %, të xhiros vjetore. Objektivi kryesor i avokatëve tanë në fushën e antitrust është të sigurojnë asistencë shoqërore dhe zgjidhje tregtare efektive për klientët tanë. Ne gjithashtu i sigurojmë asistencë të vazhdueshme klientëve mbi informimet dhe cështjet procedurale përballë Autoritetit Shqiptar të Konkurrencës.

Cështjet Gjyqësore

Stafi jonë është i specializuar në zgjidhjen e konflikteve të rëndësishme dhe komplekse të biznesit. Kur konfliktet nuk mund të zgjidhen në mënyrë private dhe jashtëgjyqësore klientët mund të mbështeten në ndihmën e Studios Ligjore Shkrela për të përfituar shërbime të pakrahasueshme në cështjet gjyqësore. Ne mund t'i përfaqësojmë klientët tanë në të gjitha hallkat e sistemit shqiptar gjyqësor dhe mund të asistojmë klientët tanë përgjatë procedurave të zgjidhjes së konflikteve.

Lojërat e Fatit

Studio Ligjore Shkrela ofron konsulence ligjore efektive për të gjitha problemet ligjore të lidhura me median, lojërat e fatit, reklamën, publikimet, internetin. Ne i ofrojmë klientëve tanë konsulence në lidhje me problemet dhe procedurat për liçencimin e lojërave të fatit etj.

Prokurimet Publike dhe Privatizimet

Sfidat që tashmë po përballon sektori publik përfshijnë përfitimin e një vlere më të madhe nga ortakët e biznesit dhe ofrojmë zgjidhje të reja që përshtaten me ndryshimet në atë cka kërkon shoqëria dhe politika dhe kërkesa për ndryshim. Disa nga shërbimet kryesore që Studio jone ofron në këtë fushë janë :

- Këshillime për procedurat e prokurorimeve publike;
- Kujdesi i duhur dhe vlerësimi i gjëndjes të pasurive që do të blihen;
- Asistencë në përgatitjen e prokurorimeve publike dhe/ose ofertat për tendera;

Mjedisi

Studio jone ka si qellim kryesor arritjen e objektivave të klientëve duke minimizuar risqet mjedisore dhe të asistojmë bizneset në përmbushjen e të gjithë sfidave mjedisore në një kontekst tregtar. Ne punojmë direkt me klientët tanë në lidhje me problemet mjedisore të tilla si Liçencime dhe Cështje Gjyqësore që lindin në fushën e Mjedisit. Ne punojmë së bashku me ekspertët teknik dhe kolegët tanë me të mire të fushës për t'i ofruar klientëve tanë zgjidhjet me të përshtatshme dhe praktike.

STUDIO LIGJORE SHKRELA

Perfaqesuar nga

Av. Ilirjan SHKRELA